



NORA NE
DORRËM 05.10.2020



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I ANGLISHTES

Tirane, 20.10.2020

Lënda: Përcillen kriteret dhe kërkesat për personelin akademik me kontratë pune të përkohëshme (personnel akademik me kohë të pjesëshme) për vitin akademik 2020 - 2021.

Prof.Dr. Artur SULA
Dekan i Fakultetit të Gjuheve të Huaja

Në përgjigje të shkresës së Rektorit, Nr. 2990, datë 19.10.2020, Departamenti i Anglishtes propozon kriteret e mëposhtme për konkursin për personel akademik me kontratë pune të përkohëshme (personel akademik me kohë të pjesëshme) për vitin akademik 2020-2021.

Kandidati konkurent duhet të plotësojë këto kriteret dhe kërkesa:

1. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
2. Të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin e punës për të cilin konkuron;
3. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një vepre penale me dashje;
4. Të mos ketë qënë i dënuar me parë për vepra penale apo kundërvajtje penale;
5. Të mos jetë nën hetim ose gjykim për çështje penale ose kundërvajtje administrative;
6. Të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna, nga Universiteti i Tiranës;
7. Të zotërojë diplomë universitare 4-vjeçare ose 3 + 2 vjeçare në fushën e gjuhës angleze, me notë mesatare mbi 8.5;
8. Të përballojë ngarkesë mësimore minimale prej 120 orë vjetore, të shtrirë gjatë vitit akademik 2020-2021, në përputhje me kërkesat dhe mundësitë e Departamentit të Anglishtes;
9. Të zhvillojë procesin e mësimdhënies detyrimisht në oraret e përcaktuara nga Departamenti i Anglishtes;
10. Perparesi kane pedagoget e jashtem, te cilet plotësojnë këto kriteret, kane qene aktivizuar gjate vitit akademik 2019-2020 dhe u jane nenshtruar procedurave te intervistimit ;

Kandidatët të cilët konkurojnë rishtas të paraqesin në Zyrën e Burimeve Njerezore deri ne daten **02 nëntor 2020** dosjet e tyre në të cilat të përfshihen dokumentet e poshtëshënuar:

1. Kërkesë me shkrim
2. CV
3. Kopje të diplomave dhe të listave të notave (të noteruara)
4. Kopje të diplomave të gjuhëve të huaja (të noteruara)
5. Tituj ose grada shkencore (nëse ka, të noteruara)

6. Vërtetim të qendrës së punës ku punon dhe të pagës që ai merr
7. Fotokopje të një mjeti identifikimi
8. Dëshmi penaliteti (ose vetëdeklarim)

Pedagoget e jashtem, te cilet plotësojnë këto kriteret, kane qene aktivizuar gjate vitit akademik 2019-2020 dhe u jane nenshtruar procedurave te intervistimit, do të riparaqesin në Zyrën e Burimeve Njerezore deri ne daten **02 nëntor 2020** vetëm kërkesën me shkrim;

Kandidatët, të cilët konkurojnë rishtas, do t'i nënshtrohet testimit me gojë (intervistë) përpara komisionit të vlerësimit të Departamentit të Anglishtes ditën e mërkurë, datë **04 nëntor 2020, ora 10.00**, në Departamentin e Anglishtes

Kandidatët e përzgjedhur nga Komisioni i Vlerësimit do të kontraktohen në bazë të nevojave dhe kërkesave për përballimin e ngarkesës mësimore të Departamentit të Anglishtes.

Faleminderit për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin

PERGJEGJESI I DEPARTAMENTIT

Prof. Dr. Viktor RISTANI